



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI KOMBËTAR PËR CERTIFIKIMIN ELEKTRONIK

UDHËZIM NR. 5

**PËR DOKUMENTACION E RREGJISTRIMIT TË OFRUESIT TË SHËRBIMIT TË
CERTIFIKIMIT**

Në mbështetje të ligjit Nr. 9880, date 25.02.2008, "Për nënshkrimin elektronik", dhe të VKM Nr. 525, datë 13.05.2009, "Rregullore për nënshkrimin elektronik", Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik,

UDHËZON:

Të gjithë personat fizik ose juridik, që duan të regjistrohen për të kryer shërbimin e certifikimit elektronik, duhet të paraqesin dokumentet e poshtëshënuara:

- Vërtetim nga Gjykata dhe Prokuroria e Rrethit se, personi nuk është në procedim penal (në rast se subjekti është person fizik);
- Deklaratë nga Ofruesi i Shërbimit të Certifikimit se, nuk është në proces gjyqësor brenda kufijve të Republikës së Shqipërisë;
- Vërtetim nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit për regjistrimin e biznesit;
- Vërtetim nga Zyra e Përmbarrimit të Rrethit se, subjekti nuk është në proces falimentimi dhe kapitalet e tij nuk janë në duar të përmbarrimit dhe në proces konfiskimi;

- Vërtetim nga Zyra e Tatim Taksave për shlyerjen e detyrimeve tatimorë;
- Vërtetim nga Zyra e Tatim Taksave për aktivitetet dhe llojet e tyre që figurojnë te regjistruara në emër të njëjtit subjekt;
- Vërtetim nga Banka ose Kompani Sigurimi të licencuara në fushën e sigurimeve për depozitim të garancisë financiare të përcaktuar sipas nenit 41 të Ligjit, dhe pikës 6 të VKM Nr. 525, datë 13.05.2009, "Rregullore për nënshkrimin elektronik".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

20/07/2009

DREJTORI

Sadi HOTI